



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 23, datë 28.12.2020

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“PARKU FOTOVOLTAIK BLUE 1”, “PARKU FOTOVOLTAIK BLUE 2”,
ME VENDNDODHJE NË BASHKINË FIER

Në mbështetje të 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive “Matrix Konstruksion” sh.p.k. dhe “Blessed Investment” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Parku fotovoltaik Blue 1”, “Parku fotovoltaik Blue 2”, me vendndodhje në Bashkinë Fier, me subjekte zhvilluese shoqëritë “Matrix Konstruksion” sh.p.k dhe “Blessed Investment sh.p.k”,
2. Hartat e Planvendosjes së Strukturave të objektit: “Parku fotovoltaik Blue 1”, “Parku fotovoltaik Blue 2”, bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

